

**QËNDRIMI I TRE RILINDËSVE SHQIPTARË PËR ALFABETIN E  
GJUHËS SHQIPE – GJERGJ QIRIAZI, FAIK KONICA, MIT'HAT  
FRASHËRI**

**THE ATTITUDE OF THE THREE ALBANIAN RENAISSANCE REPRESENTATIVES FOR THE  
ALBANIAN LANGUAGE ALPHABET – GJERGJ QIRIAZI, FAIK  
KONICA, MIT'HAT FRASHËRI**

**Farketa DIBRA-ZEQIRI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology "Blazhe Koneski", Ss. Cyril and Methodius University in Skopje*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: farketadibra@gmail.com*

---

**Abstract**

This paper aims to give an overview of the stances of three Albanian Renaissance representatives on the Albanian language alphabet and script. This comparison of three important figures of the National Renaissance offers a deeper understanding of their opposing opinions. Gjergj Qiriazi defended the Albanian alphabet that we know and use today, Mit'hat Frashëri the Istanbul alphabet, whereas Faik Konica attacked almost every participant of the Alphabet Congress, underlining that those who claimed to having the ability to solve the issue of the alphabet and the script, did not possess the skills to do so. The objective the paper strives to fulfill is to reflect and summarise opposing stances, proving the difficulty of solving the issue of the alphabet and the discussions that had to be overcome.

These Renaissance representatives were selected since each of them represents a specific branch of the Albanian culture: Mithat Frashëri comes from the Frashëri family, in a way- the main promoters of the National Renaissance, Gjergj Qiriazi comes from the group representing the Bible Society, with the mission to translate the Gospel into Albanian, whereas Faik Konica had Western values and a completely different approach towards the Albanian culture as well as the Albanian alphabet. The article will be enriched by stances and opinions of other authors defending the Arab and Greek scripts for the Albanian language. This study is built by referencing articles by the above-mentioned authors on the Albanian language alphabet.

**Keywords:** Alphabet Congress, Albanian language, National Renaissance, Gjergj Qiriazi, Mit'hat Frashëri, Faik Konica.

**Përmbledhje**

Në këtë kumtesë synojmë të pasqyrojmë qëndrimin e tre rilindësve shqiptarë lidhur me çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe. Kjo përfaqësojë mes tri figurave të Rilindjes Kombëtare do të na ndihmojë për t'i kuptuar qëndrimet e tyre të kundërta. Gjergj Qiriazi e mbroste alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe, Mit'hat Frashëri e mbroste Alfabetin e Stambollit, ndërsa Faik Konica i sulmonte gati të gjithë pjesëmarrësit e Kongresit të Alfabetit, duke pretenduar se ata që i kishin dalë zot alfabetit nuk ishin të aftë për ta zgjidhur atë çështje.

---

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v11.i21-22.p2594>

---

Synimi i kumtesës është të pasqyrohen përmbledhtazi qëndrimet mbase më të kundërta, për të dëshmuar se sa e vështirë ka qenë të zgjidhet tema e alfabetit dhe nëpër çfarë debatesh ka kaluar ajo. Përzgjedhja e këtyre tre rilindësve është bërë me qëllim, sepse të tre ata përfaqësojnë nga një degë të veçantë të kulturës shqiptare: Mithat Frashëri vjen nga loza e frashërllinjve, që – në një mënyrë – ishin promotorët kryesorë të Rilindjes Kombëtare, Gjergj Qiriazi vjen nga grupi që përfaqësonte Shoqërinë Biblike, që kishte për mision përkthimin e Ungjillit në gjuhën shqipe, ndërsa Faik Konica ishte një personalitet me kulturë perëndimore dhe kishte qasje krejt tjetër kundrejt kulturës shqiptare, rrjedhimisht edhe ndaj alfabetit shqip. Kumtesa do të pasurohet pjesërisht edhe me qëndrimet e disa personaliteteve të tjera që e mbronin qëndrimin e shkronjave arabe e greke për gjuhën shqipe. Punimi do të ndërtohet duke iu referuar shkrimeve që këta autorë i kanë botuar mbi alfabetin e gjuhës shqipe.

*Fjalët çelës:* Kongresi i Alfabetit, gjuha shqipe, Rilindja Kombëtare, Gjergj Qiriazi, Mit'hat Frashëri, Faik Konica.

---

## 1. Hyrje

Kongresi i Manastirit, përbën një nga ngjarjet më të shënuara në historinë e kulturës dhe të kombit shqiptarë, kurorëzoi me sukses përpjekjet që u bënë gjatë shekujve për lëvrimin e gjuhës shqipe, për të përpunuar një alfabet sa më të saktë e sa më të përshtatshëm për shkrimin e shqipes dhe të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Dishepujt e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ishin koshient se që të arrihet deri te formimi i gjuhës dhe i shkrimit të njësuar, shqiptarët duhet të bënin përpjekje të mëdha për zgjimin kombëtar, për bashkimin e tyre, për luftimin e propagandave përçarëse të të huajve dhe të dobësive të tjera.

Duke jetësuar këto qëllime njëkohësisht synohej t'i tregohet botës se shqiptarët nuk janë as turq, as grekë e as latinë, siç i paraqitnin armiqtë e tyre, por se ata janë një komb i veçantë me tradita e doke, me të kaluarën historike, me gjuhën e vet, etj. Shqipja e shkruar vërtet ka një histori të hershme, porse vendosja përfundimtare e një gjuhe relativisht të standardizuar, me alfabet të vetin, me drejtshkrim dhe rregulla të fiksuara ka qenë proces me zgjatje pak më të mëdha. Gjatë këtij procesi shkrime të llojeve të ndryshme kanë qenë në përdorim, në këto rrethana ku mbizotëronte një gjendje kaotike, shqipja shkruhej me një mori alfabetesh, si ai: grek, turk, arab, latin etj.

Në rrethana të tilla, vendosja e një alfabeti të njëjtë të gjuhës shqipe do të arrihej jo vetëm në luftë me sunduesit e huaj osmanë, që përpiqeshin ta pengonin atë si një arritje që do të çonte në afirmimin e mëtejshëm të kombit shqiptar, por edhe duke kapërcyer frymën dhe interesat lokale të shoqërive e të grupeve kulturore shqiptare, që ushqeheshin edhe nga ndasitë krahinore të trashëguara nga e kaluara. Ndonëse në thelb ishte një çështje kulture, njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe paraqiste njëherazi një nga problemet më të rëndësishme politike të kohës, zgjidhja e të cilit do të varej nga zhvillimi i lëvizjes kombëtare në përgjithësi.<sup>167</sup>

Ndryshe thënë, njësimi i alfabetit qe bërë nevojë e ditës për hir të zhvillimit të kulturës dhe forcimit të ndërgjegjes kombëtare. Detyrën e njësimin të alfabetit të shqipes historia ia ngarkoi ta zgjidhte Kongresit të Manastirit, i cili u thirr me nismën e klubit “Bashkimi” të Manastirit, që luante rolin kryesor ndërmjet klubeve shqiptare. Drejtuesit e këtij klubi, menjëherë pas themelimit të tij, e shpallën zgjidhjen e kësaj çështjeje si detyrën më të ngutshme të lëvizjes kombëtare.

Gjatë muajve gusht-shtator, pasi kishte marrë edhe pëlqimin e klubeve e të shoqërive të tjera atdhetare, klubi i Manastirit ndërmori masat konkrete për thirrjen e kongresit kombëtar për çështjen e alfabetit. Nisma e tij u prit mirë nga atdhetarët shqiptarë dhe nga klubet e shoqëritë patriotike brenda e jashtë vendit, që u treguan të gatshme të dërgonin përfaqësuesit e tyre në këtë kongres. Para delegatëve shtruhej detyra të shqyrtonin tre alfabetet kryesore dhe prej tyre të hartohesh alfabeti i ri.

---

<sup>167</sup> <https://klankosova.tv/pse-konica-refuzoi-kongresin-e-manastirit/>, shkarkuar më 26.12.2023.

Prugët qenë tre: 1. Nëse duhet të përshtatnin njërin nga tre alfabetet kryesore: të “Stambollit” të “Bashkimit” apo të “Agimit.” 2. Nëse duhet t’i kombinojnë të tria në një. 3. Nëse duhet t’i lënë mënjane të tria dhe të adoptojnë një tjetër krejt të ri. Në këto rrethana, pas tri ditë diskutimesh (17-19 nëntor), anëtarët e komisionit, sikurse thuhej në vendimin e kongresit, “të shtyrë edhe nga disa shkaqe të përjashtme”, nuk arritën të caktonin një alfabet të vetëm për gjuhën shqipe, prandaj vendosën që të mbahej alfabeti i Stambollit me disa ndryshime dhe krahas tij, të përdorej një tjetër me shkronja latine, si më praktik për shtypjen e librave dhe transmetimin e telegrameve me kodin Mors.

Kjo zgjidhje kompromisi që e domosdoshme që kongresi të mos dështonte. Vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabetet u mor për të mos shkaktuar përçarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Në të njëjtën kohë u quajt si një zgjidhje e përkohshme për të kaluar në të ardhmen në përdorimin e një alfabeti të vetëm, atë latin të cilin e përdorim sot. Përtej shumë anëve dhe çështjeve të rëndësishme të cilat janë ndriçuar nga studiues, gjuhëtarë, historianë, shkrimtarë, etj., rreth Kongresit të Manastirit, kujtojmë se ka edhe çështje të cilat nuk janë prekur ose më mirë thënë nuk janë ndriçuar aq sa duhet.

E kemi fjalën për interesat personale të pjesëmarrësve ose thënë ndryshe përfitimet materiale të zgjidhjes që do të miratohej, interesat e palëve që përfaqësonin, si dhe përmbylljen e ambicieve vetjake, që janë të natyrshme kur dikush është i vetëdijshëm se merr pjesë në një ngjarje madhështore që shënohen me shkronja të arta në histori. Nisur nga ky këndvështrim e pamë të arsyeshme që në këtë kumtesë të shtjellojmë qëndrimin e tre figurave markante të Rilindjes Kombëtare, Gjergj Qiriazi, Mit’hat Frashërit dhe Faik Konicës.

Në qëndrimin tonë ka përplasje mendimesh mes këtyre tre personaliteteve për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe ku secili përpiqet të mbrojë interesat e degës që përfaqëson. Gjergj Qiriazit përfaqësonte Shoqërinë Biblike, ishte figura qendrore e Kongresit të Manastirit, organizatori kryesor, i cili kishte rolin e nënkryetarit në Kongresin e Manastirit. Nga raportet që Gjergj Qiriazit ua dërgonte përfaqësuesve të Shoqërisë Biblike arrimë të kuptojmë qëndrimin dhe interesat e tij, i cili nuk përfaqësonte vetëm Shoqërisë Biblike, por na del figura kryesore "jo thjeshtë si nënkryetar i Kongresit, por si burim i njoftimeve më të plota dokumentare për Kongresin, madje edhe për diplomacinë e opinionin e huaj".<sup>168</sup>

Faik Konicën e kemi zgjedhur se është njëri ndër intelektualët më të mëdhenj të kohës, i cili nëpërmjet revistës "Albania" ka ndërmarrë aktivitetet nga më të ndryshmet për gjuhën shqipe dhe për zgjedhjen e një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Ka hartuar edhe një alfabet mbështetur në atë latin, gjithashtu konsiderohet si promotori kryesor i gjuhës shqipe në përfundim. Mit’hat Frashëri është i biri i Abdyl Frashërit dhe nipi i Sami Frashërit, hartuesit të alfabetit të Stambollit, në Kongresin e Manastirit përfaqësonte Shoqërinë e Stambollit, por ishte edhe më i privilegjuari nga delegatët e tjerët, meqenëse u zgjodh në rolin e kryetarit të Kongresit të Manastirit.

Qëndrimet e të tre personaliteteve do t’i pasqyrojmë të argumentuara duke u mbështetur në artikujt që kanë botuar në gazetën e kohës "Ilirija" dhe "Albania", pas përfundimit të Kongresit të Manastirit, gjithashtu do t’u referohemi dhe raporteve që Gjergj Qiriazit ua ka dërguar përfaqësuesve të Shoqërisë Biblike ku i ka njoftuar në hollësi me rrjedhë e punimeve nga fillimi e deri në përfundim të Kongresit të Manastirit, por edhe pas tij.

## **2. Qëndrimi i Faik Konicës për alfabetin e gjuhës shqipe**

Me shumë të drejtë nga shumëkush mund të parashtrahet pyetja pse Faik Konica, një nga dijetarët më të përgatitur në fushën e gjuhës dhe letërsisë, një nga drejtuesit e revistës më në zë të kohës "Albania" nuk mori pjesë në Kongresin e Manastirit? Përgjigjen e kësaj pyetjeje si dhe

---

<sup>168</sup> Xhevat Lloshi, *Njoftimet për Kongresin e alfabetit*, Simpoziumi shkencor 95 - vjetori i Kongresit të Manastirit, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, Shkup, 16-18 nëntor, 2023, f. 190.

shumë të tjera lidhur me qëndrimin e Konicës mbi vendimet e Kongresit të Alfabetit, si dhe raportet që ka pasur me qiriazët dhe frashërllinjët dali haptas në artikuj të ndryshëm të gazetës "Albania" nga viti 1897-1909. Konica për alfabetin latin u angazhua me një seriozitet të jashtëzakonshëm, në vitin 1897 në faqet e revistës "Albania" (Bruksel-Londër, 1897-1909) nisi një debat, në të cilin autorët shprehnin parapëlqimet e tyre kundrejt alfabeve.

Kjo ka rëndësi për të ditur se me çfarë pikëpamjesh do të vinin në Manastir delegatët. Vetë Konica ishte kundër alfabetit të Stambollit dhe nuk pëlqente as alfabetin e autorëve të vjetër, por anonte më shumë nga ai i Shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës. Meqë mëtonte (nr. 7, 1897) se nga 387 letra të ardhura për revistën, vetëm 103 ishin me alfabetin e Stambollit, u detyrua Mit'hat Frashëri t'i përgjigjej (nr. 10), se përkundrazi, ky ishte më i miri, më i bukuri dhe pa asnjë të metë, prandaj nuk kishte lëkundje për ta bërë të pranuar nga të gjithë alfabetin e Stambollit. Dy qëndrime ashpërsisht të kundërta ishin përvijuar pa u mbyllur shekulli XIX.<sup>169</sup>

Konica mendonte se shqiptarët nuk janë të aftë që të zgjidhin një çështje të tillë, andaj u drejtoi 15 gjuhëtarëve të huaj pyetje për tri çështje themelore: *a duhen pranuar shkronjat dyshe; a mund të pranohen njëkohësisht shkronjat njëshe dhe dyshe; a do të kishte një pamje të keqe, nëse zbatoheshin bashkëtingëllore prej disa shkronjash.* Përgjigjet e këtyre pyetjeve kanë ardhur nga numri 7 i revistës "Albania" dhe janë mbyllur në numrin 10 me këto përgjithësime: *lehtësia për gjetjen e shtypshkronjave; nuk ka alfabe të përpunueshme plotësisht me shqiptimin, madje po të synojë alfabeti të paraqesë gjithë nuancat e shqiptimit, do të bënte shumë më keq sesa më mirë.*<sup>170</sup>

Edhe pse alfabeti i Stambollit në vitin 1879 ishte ndër më të përhapurit në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme, qeveria osmane më 1898 kishte ndaluar me urdhër hyrjen në Shqipëri të çfarëdo libri me alfabetin e Stambollit, ndërsa Konica në nr. 1 të revistës për vitin 1902 alfabetin e Stambollit, të cilin e mbronte Frashëri, e quante "turk-moskov", "të ndyrë në të pamë", që e përdorin "nja 10 zaptieh këmbëqelbur të Toskërisë"; na ishte alfabet "i memurëve dhe i zaptiheve, i harbutëve e i ylefhive, me hije aziatike, i egër".

Që në vitin e parë (nr. 7) pasi e fajësonte alfabetin e Stambollit, se i kishte rënduar të metat e gjithë alfabeve të tjera, vijonte me një pohim nihilist: "çështja e shkrimit të shqipes do të zgjidhet vetëm kur të ndodhë një ndryshim politik në Shqipëri".<sup>171</sup> Mirëpo, shqiptarët nëse i pritnin ndryshimin politik, pra Pavarësinë e Shqipërisë kjo çështje do të ndërlikohej edhe më keq, *do të humbiste mprehtësinë e vet dhe do të ishte thjesht punë e orientimeve kulturore dhe e teknikës tipografike.*<sup>172</sup>

Të gjitha diskutimet që u realizuan vite me radhë në revistën "Albania" rreth zgjidhjes së një alfabeti të përbashkët, Konica i kishte analizuar thellësisht dhe kishte projektuar mbajtjen e një kongresi vitin e ardhshëm në Elbasan. Këtë ide ua kishte bërë të ditur të gjithë atyre që kishin dërguar shkrime në revistën "Albania" dhe kishin treguar gatishmërinë për zgjidhjen e kësaj çështje njëherë e mirë. Konica ishte i vetëdijshëm se organizimi i një kongresi të tillë nuk është çështje aq e thjeshtë, duke ditur edhe qëndrimet përçarëse të shqiptarëve, andaj që të realizohet qëllimi i vërtetë mendonte, se ky kongres duhet të përmbushte dy kërkesa:

1. Të mblidhet një komision i cili do ta analizojë projektin e kongresit;
2. Të lihet një hapësirë kohore prej një viti në mes të botimit të projektit nga komisioni dhe mbledhjes së kongresit.

<sup>169</sup> <https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit/>, shkarkuar më 26.12.2023

<sup>170</sup> <https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit/>, shkarkuar më 26.12.2023

<sup>171</sup> <https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit/>, shkarkuar më 26.12.2023

<sup>172</sup> <https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit/>, shkarkuar më 26.12.2023

Konica i kishte planifikuar edhe emrat e figurave që do të ishin pjesëmarrës në këtë komision, i cili nuk do të merrte përsipër të zgjedh çështjen e alfabetit; do të gjente vetëm tokën për t'i bashkuar të gjithë kundërshtimet e arsyeshme të një kongresi më të gjerë, dhe në fund do të emërtonin edhe një gjuhëtarë të huaj, i cili do të ndërhynte në raste të mosmarrëveshjeve.<sup>173</sup> I gjithë plani i thurur me mjeshtëri nga Konica arriti të realizohet ashtu siç shprehet ai nga "kundërshtarët e tij", të cilët posa morën vesh lajmin vepruan menjëherë. Në fakt, ngjarjet treguan se në plan të parë kishin dalë interesat grupore, mbase edhe personale se kush do ta merrte flamurin e triumfit.

Konica mendonte se ai duhet të jetë prijatari, duke konsideruar se nuk ka njeri në Shqipëri që të ketë luftuar aq sa ai për alfabetin latin, andaj në artikullin "*Kongresi i shqipëtarëve xhonturq në Maqedhonië*", botuar në revistën "Albania" në 1909, kundër organizatorëve të kongresit shprehet në këtë mënyrë: "*kur u muar vesh projekti ynë, ca njerës të poshtër... mbluathnë fshehtazi dhe me vrap miqt' e tyre dhe bënë një "kongres"; po që të dëftojnë karakterin e tyre, këta njerës me një methudë të njohur t Anadollakëve, ftuan edhe gjithë kundërshtarët e tyre ... n'orën e fundit. Të tillë njerës të pafamëshm kanë sy e faqe të thohen për vëndësit e kombit shqiptarë! Të tilë dishepuj të mjeshtërisë halldupe kuxojin gjer die t'i lëpjin Evropës ndihmë posi Evropianë!...*"<sup>174</sup>

Nga ky citim del qartë se ftesa për pjesëmarrje Konicës i është dërguar në momentet e fundit ashtu siç pohon ai, edhe pse disa herë e ka mohuar këtë duke trilluar një varg argumentesh të rreme. Ftesën ia kishte dërguar Kristo Qiriazit (vëllai i Gjergj Qiriazit) në emër të Klubit të Manastirit, duke e renditur ndër njerëzit "nga të parët ndër këtë punë". Përgjigjja e Konicës është duke shtrembëruar datat dhe shumë fyese për Kriston, meqë nuk ia paskan dërguar njoftimin të parit atij, sepse ai e ka "më të vjetrën fletë shqipe". Edhe kjo ishte thjesht një e pavërtetë, ndërsa pjesëmarrësit Konica i quan "pilaçinjturq" dhe "këmbëlëpinjës të krishterë".<sup>175</sup>

Në letrën që ia dërgon Ministrisë së Jashtme të austro-hungarisë (Londër, 29 tetor, 1908), e njofton se agjenti i Shoqërisë Biblike të Londrës në Manastir, Gjergj Qiriazit dhe disa shqiptarë kanë vendosur të mbajnë një Kongres, duke mos ftuar asnjë kundërshtarë të paramenduar. Më tej mes tjerash shtonë se: *Unë deri tani nuk kam marrë asnjë ftesë, por edhe sikur të merrja, për arsye të shëndosha për një kohë të gjatë e kam injoruar thirrjen e një kongresi të tillë. Disa nga anëtarët e këtij kongresi të pretenduar, harruan se më kishin shkruar para dhjetëra vjetësh se veprimi im do të jetë pikënisje e pakundështueshme e Rilindjes Kombëtare.*<sup>176</sup>

Ekzistojnë supozime të ndryshme rreth mospjesëmarrjes së Konicës në Kongresin e Manastirit, duke u nisur nga ajo se Konica u prek në sedër, u fye që nuk e përfillën, që Komiteti nismëtar i Manastirit ia dërgoi ftesën shumë vonë, sa për të larë gojën, vetëm disa ditë para kongresit. Ka të ngjarë që komiteti hezitoi ta ftonte Konicën nga druajtja se ai do të kërkonte t'u impononte alfabetin e përdorur prej tij,<sup>177</sup> prandaj, në punimet e Kongresit të Manastirit, alfabeti i tij nuk u përmend fare, sikur të mos ekzistonte. Supozohet gjithashtu se komiteti nismëtar e mënjanoi Konicën, për arsye të acarimeve midis tij dhe Mitat Frashërit, kryetarit të Kongresit. Nga letra e Konicës del se qenka zemëruar me të edhe Gjergj Qiriazit, "për arsye të Antologjisë që botoi Konica dhe ca më tepër se mori anën e priftit shqiptar."<sup>178</sup>

<sup>173</sup> Xhevat Lloshi, *Gjergj Qiriazit në Kongresin e Manastirit*, vëllimi II - Dokumente dhe shkrime, Shkup, 2019, f. 366.

<sup>174</sup> Faik Konica, "Albania", vol. XII, nr. 1, 1909, f. 24-33.

<sup>175</sup> <https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit/>, shkarkuar më 26.12.2023.

<sup>176</sup> Xhevat Lloshit, *Gjergj Qiriazit në Kongresin e Manastirit*, vëllimi II - Dokumente dhe shkrime, Shkup, 2019, f. 361-362. Kjo letër është botuar në "*Letërkëmbimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare*", Prishtinë, 2014, f. 240-243.

<sup>177</sup> <https://archive.koha.net/?id=4&l=99349> shkarkuar më 26.12.2023.

<sup>178</sup> <https://archive.koha.net/?id=4&l=99349> shkarkuar më 26.12.2023.

Hipokrizia e Konicës arriti kulmin, aq sa shpifi, gënjeu dhe trilloi shumë të pavërteta rreth organizimit të kongresit, sulmoi, njollosoi, poshtëroi e mohoi shumë figura dhe heronj kombëtar vetëm e vetëm për ta lartësuar vetveten. Megjithatë, Kongresi i Manastirit u mbajt edhe pa pjesëmarrjen e Faik Konicës dhe në fund koha e vërteto të kundërtën që mendonte Konica, "se ky alfabet nuk ka për të mbyllur, por për të shtuar çarjet". Ironia më e madhe është se përkundër sharjeve dhe ofendimeve ndaj vendimeve të Kongresit të Manastirit, vetë Konica është ai që do ta përdor alfabetin latin me përjashtim të shkronjës ë në revistës "Fleta e drektorit", më vitin 1909.

### 3. Qëndrimi i Gjergj Qiriazit për alfabetin e gjuhës shqipes

Veprimtaria kulturore dhe fetare e familjes Qiriazit fillon në fillim me angazhimin e Gjerasim Qiriazit (vëllai më i madh i Gjergjit) si përfaqësues i Shoqërisë Biblike për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Krahas detyrës zyrtare, predikimit të Ungjillit shqip, ai me vëllezërit e motrat zhvillonin propagandën dhe mbillnin në zemrat e shqiptarëve dashurinë për gjuhën amtare dhe për atdheun e robëruar. Me rastin e qëndrimit në Stamboll, Gjerasimi i paraqiti portës së Lartë kërkesën për të çelur në Korçë një shkollë vajzash. Kështu, pas hapjes së "mësonjtores" për djem më 1887, më 23 tetor 1891 themelohet shkolla e parë shqipe për vajzat.

Pas vdekjes së Gjerasimit në vitin 1894, në një moshë shumë të re, vendin e tij e zuri i vëllai Gjergji, i cili u emërua si depozitar i Shoqërisë Biblike në Manastir. Gjergji ishte një veprimtarë i përfshirë thellë në lëvizjen kombëtare dhe këto dy anë pajtoheshin plotësisht në pikëpamjet dhe në punën e tij. Njëkohësisht kishte marrëdhënie të qëndrueshme me përfaqësues të huaj. Ishte përkthyes i konsullatës austro-hungare, por edhe njeriu tek i cili mbështetej më shumë se te kushdo tjetër August Krali. Fjalët nga raportet e Gjergjit botoheshin rregullisht në Raportet vjetore të BFBS, pra njoftimet e Gjergjit luanin rol parësor për të mbajtur të gjallë interesimin e të huajve për ecurinë e lëvizjes kombëtare shqiptare, për ngjarjet që lidheshin me synimet e tyre në atë pjesë të Ballkanit, domethënë për të pasur pjesë ndikuese edhe në orientimet e kulturës së vendit, për të ndihmuar shkollën shqipe, për të botuar libra.

Ai është kujdesur që të sigurojë mbështetje financiare për shtypshkronjën e Manastirit nga disa palë të huaja dhe e ka arritur këtë. Sipas analizave të tij, Shoqëria Biblike do të përcaktonte se çfarë ribotimesh të përkthimeve biblike do të bëheshin dhe çfarë përkthimesh të reja vlente të ndërmerreshin dhe sa do të ishte tirazhi dhe në cilin dialekt. Në këtë rreth bënte pjesë edhe çështja e alfabetit si hallkë e parë. Ai i ka rekomanduar Hoxhsonit që të mos ndërmerreshin shtypje të reja derisa të vendosej një alfabet i përbashkët për të gjithë vendin. Këtë e ka bërë përpara se të mbledhej Kongresi, domethënë e parashihte si të afërt.<sup>179</sup>

Në Kongresin e Manastirit Gjergj Qiriazit ishte nënkryetar dhe delegat që përfaqësonte klubin "Bashkimi" të Manastirit; anëtar i Komisionit dhe sekretar i tij; përfaqësues i "Shoqërisë Biblike Britanike" në Manastir, madje me të drejtë vote; ishte iniciatori kryesor për mbajtjen e Kongresit të Manastirit. Natyrisht, se ai priste frytet e këtij angazhimi disavjeçarë, ndaj objektivi i tij ishte i qartë, ai nuk kishte për qëllim që të linte një procesverbal për interesat e historianëve dhe filologëve. Sipas studiuesit Xhevat Lloshi<sup>180</sup> synimi i Qiriazit ishte aktual i drejtpërdrejtë: të tregojë përpara përfaqësuesve të huaj një arritje të çmueshme të lëvizjes shqiptare, t'u dëshmonte frymën e bashkimit të mishëruar në një kuvend gjithëkombëtar për të tërhequr mbështetjen e tyre të pandërprerë.

<sup>179</sup> Xhevat Lloshi, *Raportimet për Kongresin e Manastirit*, kumtesë botuar në Revistën SCUPI, vëllimi 23, 110-vjet alfabet shqip (Aktivitete të mbajtura më 21-22.11.2018 në Shkup dhe Manastir), f. 101-102.

<sup>180</sup> Xhevat Lloshi, *Raportimet për Kongresin e Manastirit*, kumtesë botuar në Revistën SCUPI, vëllimi 23, 110-vjet alfabet shqip (Aktivitete të mbajtura më 21-22.11.2018 në Shkup dhe Manastir), f. 103.

Synim i tij ishte t'i dëshmonte Shoqërisë Biblike perspektivat e reja që hapeshin, në mënyrë që ajo të vazhdonte financimin e librave shqip dhe përhapjen e tyre. Synimi i tij ishte të tregonte emrat e rilindësve me autoritet dhe shoqëritë e tyre, që kishin marrë në duar fatet e lëvizjes. Synimi i tij ishte të tregonte të ardhmen e lëvrimin të shqipes dhe të mënjanonte ndonjë dyshim për shkak të zgjidhjes si kompromis me dy alfabetet të pranuar. Dhe më së fundi, synimi i tij ishte edhe personal: me këtë mënyrë ai dëshmonte vlerën e punës së vet, që e meritonte të vazhdohej me përkrahjen e tyre, por edhe të shprehte lavdërimet e shqiptarëve kundrejt Shoqërisë Biblike.

Për shoqërinë Biblike natyra e shkronjave të shqipes kishte pasoja vendimtare për veprimtarinë e mëtejshme në Shoqëri, d.m.th. për të ardhmen. Pas fillimit në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XIX të botimeve me alfabetin e Stambollit, tashmë duhet bërë një kthesë tjetër. Për më tepër, shtypshkronja e Manastirit do të përdorte shkronjat e reja të shqipes. Kështu, pas botimit të disa ungjijve të veçantë më 1909, doli Dhiata e re e plotë toskërisht më 1910 në Manastir. Pas kësaj deri më 1914 në këtë shtypshkronjë do të shtypeshin edhe gjashtë libra të Dhiatës së vjetër me alfabetin e sotëm, pra mund të përfundojmë se Gjergj Qiriazi arriti ta përmbush me sukses objektivin e tij duke bërë kthesë historike me vendosjen e alfabetit latin ndër shqiptarët.

#### 4. Qëndrimi i Mit'hat Frashërit për alfabetin e gjuhës shqipe

**Mit'hat Frashëri i njohur me pseudonimin Lumo Skëndo është djali i Abdyl Frashërit, nipi i Naimi dhe Sami Frashërit. Konsiderohet si euriditit shkencor dhe figura qendrore e gjithë Lëvizjes Kombëtare të Rilindjes; kryetar i klubit të Selanikut; botues i gazetës "Lirija"; drejtues i revistave "Kalendari kombiar" dhe "Dituria"; deri në vitin 1905 ishte nëpunës i Ministrisë së Brendshme të xhonturqve; më 1908 jo thjesht përkthyes apo nëpunës në Selanik, por sekretar i Hilmi Pashës; në fund të vitit 1910 u bë drejtor i punëve politike në Selanik; mbështetës kryesor i Alfabetit të Stambollit; në Kongresin e Manastirit ishte delegat i Janinës dhe i Selanikut me të drejtën e dy votave.<sup>181</sup>**

**Në Kongresin e Manastirit do të jepet roli i kryetarit. Ekzistojnë dyshime se kjo ka qenë edhe arsyeja pse nuk u paraqit ditën e parë të kongresit, me sa duket ka pritur të mësojë pozicionin që do t'i caktonin. Pasi kuptoi se e kanë emëruar në rolin e kryetarit (imponuesit), të nesërmen paraqitet në kongres duke mos dhënë asnjëfarë shpjegimi pse mungoi ditën e parë të një ngjarje kaq të rëndësishme, siç ishte Kongresi i Manastirit.**

"Mit'hat Frashëri kishte ardhur në kongres me qëllimin për ta shndërruar alfabetin e Stambollit në alfabet mbarëkombëtarë dhe kokëfortësia e tij për ta arritur këtë është arsyeja e zgjidhjes së kompromisit". Edhe pas mbyllje së Kongresit, Mit'hati e ka shprehur, se nuk do të mbeteshin të gjithë të kënaqur, duke qenë vetë i pari i pakënaqur".<sup>182</sup> Andaj, më 5 dhjetor të vitit 1908 në faqet e gazetës "Ilirija" shkruan artikullin *Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit?* Vetë titulli i artikullit shpreh qartë qëndrimin e M. Frashërit se në kongres ka marrë pjesë me bindjen se do të dalë fitimtar, edhe pse ishte i vetëdijshëm se nder shqiptarët nuk përdorej vetëm alfabeti i Stambollit, andaj pas kongresit ndihet i zhgënjyer.

Që në rreshtat e parë të artikullit shprehet: *se di se si u gënjyen, a më mirë u gënjyem*, meqenëse ai priste të zgjidhet vetëm një alfabet e jo dy, e ndien veten të mashtruar dhe e pranon se e ka humbur betejën. Rezultati më i madh që u arrit në këtë kongres, sipas Mit'hat Frashërit ishte bashkimi kombëtar dhe jo zgjidhja e kompromisit, ndaj brenda artikullit shprehet: *"Ky bashkim i abeëve, kjo ndarje nga një çështje bizantine, që na nxinte faqen gjer më sot, është pema e parë e kongresit. Po ka edhe një pemë tjetër, që është mbase më e madhe dhe më e*

<sup>181</sup> [https://www.academia.edu/41041800/Gj\\_Q\\_N%C3%AB\\_Kongres](https://www.academia.edu/41041800/Gj_Q_N%C3%AB_Kongres), f.61, shkarkuar më 26.12.2023.

<sup>182</sup> [https://www.academia.edu/41041800/Gj\\_Q\\_N%C3%AB\\_Kongres](https://www.academia.edu/41041800/Gj_Q_N%C3%AB_Kongres), f.61, shkarkuar më 26.12.2023.

*bukur. Edhe kjo pemë është bashkimi i shqiptarëve".*<sup>183</sup> Nga mbledhjet që u mbajtën në Kongresin e Manastirit ditë me radhë, shqiptarët paraqiten edhe si njerëz të qytetëruar përpara të huajve, që deri dje i konsideronin se nuk janë të zotit për asnjë vepër të qytetëruar, me këtë bashkim i tregohet botës se shqiptarët nuk janë ashtu si i pandehin të huajt, s'qenkan aq "të egër" sa thuhej. ***Ky kongres, kjo shenjë e parë që dhamë për qytetari, na shtoi nder përpara syve tanë dhe përpara syve të botës. Le të tregohemi, pra, gjithnjë të zotë, që të mbajmë dhe ta shtojmë këtë nder".***<sup>184</sup> **Me këtë uratë Mit'hat Frashëri e përmbyll artikullin *Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit?***

Mit'hat Frashëri ishte i vetëdijshëm se edhe pse u zgjodhën dy alfabetet për t'u përdorur njëkohësisht, ai latin do të mbizotëronte, ndërsa alfabeti i Stambollit do të shuhej brenda një haku të shkurtër kohor. Një fakt i tillë u vërtetua menjëherë pas Kongresit të Alfabetit ku Konsulli austriak në Manastir, P. Postlin, ka dërguar një raport më 14 dhjetor nga Manastiri (Dokumenti Nr.3), në të cilat vetëm një muaj pas vendimeve të Kongresit të Alfabetit, shprehet qartë se, ndonëse u pranuan dy alfabetet, "do të përkrahet kalimi në alfabetin latin si i vetmi alfabet për gjuhën shqipe, gjë që është paraparë nga një parti e rëndësishme atdhetarësh shqiptarë (siç janë: Fehim bej Zavalani, Dhimitraq Buda, Grigor Cilka, at Fishta, Sotir Peci, Luigj Gurakuqi e tij.). Vendimi i këtij raporti e vulosi përfundimisht jetëgjatësinë e alfabetit latin dhe përmbysim kontributi dhe punën disa vjeçare dhe shumëdimensionale të rilindësve e të frashërllinjëve.

## 5. Përfundim

Nga e gjithë kjo që trajtuam deri tani lidhur me përjasjet e qëndrimeve të të tre rilindësve Faik Konicës, Mit'hat Frashërit dhe Gjergj Qiriazit, mund të arrijmë në përfundim, se gjithmonë kur ndodhin ngjarje të tilla që shënojnë kthesë në historinë e një populli, ka fërkime, përplasje dhe përpjekje për të ngritur lart njërin dhe për të ulur tjetrin, me qëllim që çdonjëri të nxjerrë në pah vlerat e veta dhe të arrijë në objektivin që ia ka vënë vetës qoftë kombëtar ose material.

Pavarësisht përpjekjeve të të tre rilindësve se kush do të dalë prijatarë, Kongresi i Manastirit ishte një fitore për mbarë shqiptarinë. Ishte një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së alfabetit të shqipes dhe ushtroi një ndikim të fuqishëm në bashkimin politik dhe përparimin e mëtejshëm kulturor të kombit shqiptar. Me këtë vendim iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes. Në vend të alfabeve të shumta që ishin përhapur në Shqipëri e në kolonitë e mërgimit, tani do të përdreshin vetëm dy, edhe këta bashkërisht. Kongresi i Manastirit ripohoi edhe njëherë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar, kundër orvatjeve të xhonturqve për t'u imponuar alfabetin arab dhe për t'i identifikuar ata me turqit.

"Atë që nuk e çoi dot deri në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë jeta e popullit shqiptar. Alfabeti thjesht latin, duke qenë i papërzier e më homogjen nga karakteri i shkronjave, më i lehtë e më praktik për shtyp, u përhap gjithnjë e më shumë dhe nga fundi i Luftës së Parë Botërore u bë tashmë alfabeti i përbashkët e i vetëm për gjithë shqiptarët, alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe".<sup>185</sup>

<sup>183</sup> Mit'hat Frashëri, *Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit*, Botim anastatik i koleksionit të plotë të gazetës "ILIRIJA" 1908-1910, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2019, f. 326.

<sup>184</sup> Mit'hat Frashëri, *Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit*, Botim anastatik i koleksionit të plotë të gazetës "ILIRIJA" 1908-1910, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2019, f. 326.

<sup>185</sup>[https://zeflushmarku.edu.mk/libra/Roli\\_historik\\_i\\_Kongresi\\_te\\_Manastirit\\_per\\_njeimin\\_e%20alfabetit%20te%20gjuhes%20shqipe.pdf](https://zeflushmarku.edu.mk/libra/Roli_historik_i_Kongresi_te_Manastirit_per_njeimin_e%20alfabetit%20te%20gjuhes%20shqipe.pdf), shkarkuar më 26.12.2023.



## Referencat

- [1]. Frashëri M. 2019. Ç'fituam nga Kongresi i Manastirit?, Botim anastatik i koleksionit të plotë të gazetës "ILIRIJA" 1908-1910, Biblioteka Kombëtare, Tiranë.
- [2]. Konica F. 1909. "Albania", vol. XII, nr. 1.
- [3]. Lloshi Xh. 2019. Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit, vëllimi I - jeta dhe veprimtaria, dokumente dhe shkrime, Shkup.
- [4]. Lloshi Xh. 2019. Gjergj Qiriazi në Kongresin e Manastirit, vëllimi II - Dokumente dhe shkrime, Shkup.
- [5]. Lloshi Xh. 2018. Raportimet për Kongresin e Manastirit, kumtesë botuar në Revistën SCUPI, vëllimi 23, 110-vjet alfabet shqip (Aktivitete të mbajtura më 21-22.11.2018 në Shkup dhe Manastir).
- [6]. Lloshi Xh. 2008. Rreth alfabetit të shqipes (me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Manastirit), Logos-A, Shkup.
- [7]. Lloshi Xh. 2003. Njoftimet për Kongresin e alfabetit, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, simpozium shkencor 95-vjetori i Kongresit të Manastirit, Shkup.
- [8]. [8.https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit](https://www.kultplus.com/opinione/110-vjet-me-pas-te-pathenat-e-kongresit-te-manastirit) shkarkuar më 26.12.2023.
- [9]. <https://klankosova.tv/pse-konica-refuzoi-kongresin-e-manastirit/> shkarkuar më 26.12.2023.
- [10]. <https://archive.koha.net/?id=4&l=99349> shkarkuar më 26.12.2013.
- [11]. [11.https://zeflushmarku.edu.mk/libra/Roli\\_historik\\_i\\_Kongresi\\_te\\_Manastirit\\_per\\_njeimin\\_e%20alfabetit%20te%20gjuhes%20shqipe.pdf](https://zeflushmarku.edu.mk/libra/Roli_historik_i_Kongresi_te_Manastirit_per_njeimin_e%20alfabetit%20te%20gjuhes%20shqipe.pdf), shkarkuar më 26.12.2023.
- [12]. [12. https://www.academia.edu/41041800/Gj\\_Q\\_N%C3%AB\\_Kongres](https://www.academia.edu/41041800/Gj_Q_N%C3%AB_Kongres), f.61, shkarkuar më 26.12.2023.